



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 350/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Hani Elezit, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Hani Elezit, për shkak të vendosjes së flamujve mbi rrugët publike të trafikut, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Hani Elezit kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1400 (njëmijë e katërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 25. 10. 2013 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV-ja, në të cilën theksohet se me datën 23 tetor 2013 në rrugën Xhemsedin Suma në Hanë të Elezit aktivist të subjektit politik PDK kanë vendosur flamujt e subjektit politik PDK mbi shtyllat e ndriçimit. Sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik PDK ka shkelur nenin 33 pika b) të LZP-së. Andaj si dëshmi ka bashkangjitur fotografit nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, për ankesën në fjalë duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e informoi subjektin politik PDK për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 28.10.2013, ora 10:00.

PZAP-i sipas afatit të paraparë pra me datën 28.10.2013 pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së janë të pabaza lidhur me shkeljen e nenit 33 pika b) të LZP-së dhe se sipas të dhënave që kanë nga tereni persona të pidentifikuar kanë vendosur flamujt e PDK-së me qëllim të dëmtimit të kësaj partie, prandaj sipas PDK-së me të kuptuar për këtë flamujt e PDK-së janë larguar menjëherë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se si flamujt e subjektit politik PDK-së në komunën e Hanit të Elezit janë të vendosura në shtyllat e ndriçimit konkretisht mbi rrugët publike të trafikut, e për të cilat veprime subjekti politik PDK konsiderohet përgjegjës sipas nenit 33 pika b) të LZP-së dhe nenin 4.1 paragrafi b) i Rregullës Zgjedhore.

Prandaj PZAP-i për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj PZAP-i, lidhur me rastin në fjalë mori parasysh të gjitha rrethanat si ato rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese PZAP-i mori se subjekti politik PDK shkelje të natyrës së tillë ka kryer edhe më parë dhe konsiderohet si recidivist. Si rrethanë tjetër rënduese mori atë se subjekti politik PDK edhe më parë ka marr pjesë në zgjedhje dhe në këto raste konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe rregullat zgjedhore. Prandaj vendosja e flamujve të PDK-së në objektet publike e bënë përgjegjës këtë subjekt politik. Ndërsa si rrethanë lehtësuese në këtë rast PZAP-i, mori parasysh faktin se PDK në pajtim me nenin 32.6 të LZP-së, ka ndërmar veprime konkrete duke i larguar menjëherë flamujt e PDK-së nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i duke i marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstaton se subjekti politik PDK është përgjegjës për veprimet e tilla dhe se mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 118.1 lidhur me nenin 120. 1 pika c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 350/2013 më datën 31.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*